



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 185, Datë 20.11.2019

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MIRATIMIN E “ KRITEREVE PËR TË
VENDOSUR KUFIZIME SIPAS KËRKESAVE PËR LIDHJEN E MODULEVE TË
GJENERIMIT”.**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 23, të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” i ndryshuar; parashikimeve të Vendimit nr. 2018/05/PHLG-EnC, datë 12.01.2018 të Grupit të Përhershëm të Nivelit të Lartë të Komunitetit të Energjisë; neneve 60; 61;62;63; 64; dhe 65 të Rregullores së Komisionit (KE) 2016/631, datë 14 Prill 2016, nenit 26 të “Rregullores për Organizimin, Funksonimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016” bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 20.11.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoritë e ERE me nr.102/9 Prot, datë 12.11.2019, për “Fillimin e procedurës për miratimin e “Kritereve për të vendosur kufizime sipas kërkesave për lidhjen e moduleve të gjenerimit “,

Konstatoi se:

- Shqipëria është anëtare e Komunitetit të Energjisë që nga data 01.07.2006;
- Transpozimi, si dhe zbatim i kodeve dhe udhëzimeve të rrjetit që dalin nga institucionet Europiane është një nga aktivitetet kryesore të punës së institucioneve përkatëse në Shqipëri.
- Autoriteti rregullator (ERE) duhet të specifikojë kriteret për vendosjen e derogimeve (kufizimeve)” sipas përcaktimeve të Neneve 62 dhe 63 të Rregullores së publikuar nga ENTSO-E, pasi të konsultohet me operatorët përkatës të sistemit dhe zotëruesit e objektit gjenerues të energjisë elektrike si dhe pjestarë të tjerë të tregut të energjisë elektrike, të cilët vlerëson se mund të preken nga këto rregulla

- Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike OST SH.A. është anëtar me të drejta të plota e ENTSO-E;
- Sipas Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, kjo Rregullore miratohet nga ERE, si detyrë që buron nga Rregullorja e Komisionit Evropian (KE) 2016/631, datë 14 Prill 2016 .

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën miratimin e “Kritereve për të vendosur kufizime sipas kërkesave për lidhjen e moduleve të gjenerimit”
2. Drejtoria e Çështjeve Ligjore të njoftojë të interesuarit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare

KRYETARI

Petrit AHMETI